

Të dua o i dërguari i Allahut, sepse Allahu të do dhe unë gjithashtu të dua.

Të dua o i dërguari i Allahut, sepse dashuria ndaj teje është afrim tek Allahu dhe adhurim për Allahun, bile prej adhurimeve më të mira.

Të dua o i dërguari i Allahut, sepse përmallohem për ty.

Te dua o i dërguari i Allahut, ashtu që Allahu të na bashkojë mua dhe ty në Xhenetin firdeus.

Të dua o i dërguari i Allahu, sepse e lus Allahun të të shoh në ëndërr.

Të dua o i dërguari i Allahut, sepse historia jote është veprimi praktik i fesë së Allahut.

Të dua o i dërguari i Allahut, sepse historia jote është sqarim i ajeteve dhe dispozitave të Kuranit.

Të dua o i dërguari i Allahut, sepse jeta jote është fe dhe moral, ai që të pason e ngritë Allahu, e ai që të kundërshton e poshtëron.

Të dua o i dërguari i Allahut, sepse fjalët dhe veprat e tua janë të mbushura me udhëzime, mirësi dhe dritë.

Të dua o i dërguari i Allahut, sepse fjalët dhe veprat e tua janë mirësi për ne në fenë tonë.

Të dua o i dërguari i Allahut, sepse ti ke bartur të gjitha vështirësitë dhe lodhjet që ne të jemi të qetë, tek ti kthehet e gjithë mirësia mbi ne pas mirësisë së Allahut.

Phoca PDF

Të dua o i dërguari i Allahut, sepse e gjithë historia jote është mësime, këshilla dhe urtësi për ne t'i meditojmë dhe të përfitojmë nga ato.

Të dua o i dërguari i Allahut, sepse Allahu na ka thënë neve se ti je shëmbëlltyrë për ne, dhe na ka urdhëruar që të dërgojmë salavate dhe selame.

Të dua o i dërguari i Allahut, sepse ti je ndërmjetësues, dëshmitar, përgëzues, kërcënues dhe thirrës drejt Allahut me lejen Tij.

Përktheu: Valdet Kamberi

Phoca PDF